



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

URDHËR

Nr. 4951, Datë 02/05/2018

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT DHE TË DHËNAVE PËR MASËN ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE, "PARALAJMËRIM ME SHKRIM"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 67, pika 3 e ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" dhe të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit dhe të dhënave për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale "Paralajmërim me shkrim" referuar modelit bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri Prokurorisë së Përgjithshme dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Etilda Gjonaj (Saliu)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA/GJYKATA

Nr. _____ Prot. _____, më ____/____/201____

Masa alternative e shmangies nga ndjekja penale "Paralajmërim me shkrim"

(Procesverbal)

I) TË DHËNAT E FAKTIT TË KALLZIMIT/PROCEDIMIT PENAL:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor/Gjykata e Rrethit Gjyqësor e përfaqësuar nga prokurori/gjyqtari _____ (emër dhe mbiemër), referuar kallzimit/procesit penal nr _____, datë/viti _____, konstaton se në datë _____, ora ____ është paraqitur i mituri _____ (emër, atësi, mbiemër), i moshës _____, vendlindja _____, vendbanimi _____, i shoqëruar nga _____, në cilësinë e _____.

Rezulton e provuar se i mituri _____ ka kryer veprën penale _____, të parashikuar nga neni ____ i Kodit Penal, me masën e dënimit _____.

II. PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE INDIVIDUALE TË TË MITURIT:

Mbështetur në raportin individual të të miturit, të përgatitur në bazë të rregullave të neneve 22 dhe 47 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, sipas të cilit:

III. SHPJEGIMET QË I JEPEN TË MITURIT LIDHUR ME:

a) veprën penale të kryer sipas përcaktimit në Kodin Penal:

b) dëmin dhe rrezikshmërinë e veprës penale:

c) mënyrën dhe sjelljen ndaj veprës së kryer:

ç) pasojat e ardhura nga vepra penale e kryer që i janë shkaktuar viktimës/ave dhe komunitetit:

d) pasojat që vijnë nga fillimi i ndjekjes penale për veprën penale të kryer dhe pasojat që mundshme ndaj të tij në rast të një dënimi penal:

dh) pasojat e mundshme në rast të përsëritjes së veprës penale dhe/ose të një vepre tjetër penale:

IV. ARSYETIMI DOMOSDOSHMËRISË NË CAKTIMIN E MASËS ALTERNATIVE TË SHMANGIES "PALAJMËRIM ME SHKRIM"

Referuar rrethanave individuale dhe nevojave të të miturit dhe duke marrë në konsideratë dobishmërinë e masës alternative të shmangies për korrigjimin dhe riintegrimin e tij, arsyetoj se:

V. NËNSHKRIMET E PALËVE DHE TË PERSONAVE TË TJERË TË PRANISHËM

Prokurori/Gjyqtari

(Emër, Mbiemër).....

(Nënshkrimi).....

I mituri

(Emër, Mbiemër).....
(Nënshkrimi).....

Përfaqësuesi i familjes së të miturit

(Emër, Mbiemër).....
(Nënshkrimi).....

Persona të tjera të pranishëm (kujdestari / përfaqësuesi ligjor/procedural / mbrojtësi / psikologu / përkthyesi / interpreti apo punonjës të tjerë të sistemit të drejtësisë për të mitur)

(Emër, Mbiemër).....
(Nënshkrimi).....

Vendi dhe data

.....

Ky procesverbal nënshkruhet në ____ kopje origjinale: një kopje për të miturin dhe/ose _____ dhe një kopje për prokurorinë/gjykatën.